



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

### DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

<b>DATË /A</b>	<b>07.09.2016</b>
<b>REFERENCË</b>	
<b>PËR:</b>	<b>z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës në Lipjan</b>
<b>Cc:</b>	<b>z. Fitim Selimi, Nënkyetar i Komunës në Lipjan z. Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës në Lipjan</b>
<b>NGA:</b>	<b>z. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtoratit të Arsimit në Lipjan</b>
<b>LËNDA:</b>	<b>Raport i punës - Muaji Gusht 01.08.2016-31.08.2016</b>

Muaji Gusht për Drejtorinë Komunale të Arsimit në Lipjan ka qenë muaj i përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor 2016-2017. Përgatitja teknike – administrative dhe higjieno-sanitare e shkollave, përgatitja e kërkesave për libra të rinjë, ditarë, fletore pune, fletore aktive dhe materiale të ndryshme shkollore pa të cilat nuk mund të filloj procesi edukativo-arsimor. Përgatitja e kërkesave për lëndë djegëse: dru, thëngjill. Ndërkaq ajo çfarë vlenë të përmendet janë investimet - furnizimet e ndryshme në shkolla duke filluar nga:

#### **Instalimi i nxemjeve qendrore në:**

- Shfmu “Migjeni” në Rufe i Ri,
- Shfmu “Shtjefën Gjeçovi” në Janjevë,
- Shfmu “Dy Dëshmorët” në Dobrajë e Madhe,
- Shfmu “Hasan Zyko Kamberi” në Sllovi,
- Shfmu “Ernest Koliqi” në Babush i Muhaxherëve dhe
- Shfmu “Katër Dëshmorët” në Krojmir.

Ndërtimi i rrethojës në Shfmu “Ernest Koliqi” në Babush i Muhaxherëve.

Rregullimi - riparimi i banjove, dyerve, dritareve dhe dysHEMEVE në Gjymnazin “Ulpiana” në Lipjan (objekti i vjetër).

Rregullimi i Olluqëve në Çerdhen në Lipjan.

Furnizimi i dy shkollave të mesme SHML Gjymnazi “Ulpiana” në Lipjan dhe SHMP “Adem Gllavica” në Lipjan me paisje kabineti: Kimi, Fizikë, Biologji, Makineri dhe Elektroteknikë.

Ndihmesë klubeve të ndryshme sportive, shoqatës së Handikos-it duke i mbuluar shpenzimet e transportit varësishtë relacionit të kërkuar.

Është bërë Implementimi i projektit “Më mëso mua” në Shfmu “Ismail Luma” në Lipjan (mësimi online).

### **Përgatitja e formularëve të personelit arsimor dhe dërgimi i tyre në MSHP dhe atë:**

- Formular për ndryshime - kthim nga lehonja, kalimi në pushim lehonie, shtimi i licencimit,
- Formular për largim - skadim kontrate, pensionim,
- Formular për punëtor të rinjë,
- Të ndryshme - ndërrim i xhirollogarisë.

Ka filluar mbajtja e trajnimeve për mësimdhënësit e shkollave Pilot të Komunës sonë.

Më datë 31.08.2016 është mbajtur mbledhje e rregullt me të gjithë drejtorët e shkollave fillore dhe të mesme në të cilën mbledhje është diskutuar në përgjithësi rreth përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor 2016-2017.

Është bërë nënshkrimi i marrëveshjes së partneritetit mes **PLAY International** dhe Drejtorit të Arsimit për zbatimin e projektit **“Sport 4Youth”** (Sporti për të Rinjët).

Përfundimi i procedurave për rekrutimin e kuadrit të ri arsimor.

Shpallja e konkursit plotësues për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-dhjetë në Gjimnaze dhe shkolla Profesionale më datë 22.08.2016.

Mbajtja e testit të Maturës Afati i Gushtit, pjesa e parë më datë 27.08.2016 dhe pjesa e dytë 03.09.2016, test të cilit i'u nënshtruan 377 maturantë.

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të ndryshme (kërkesa për punësim, pushim mjekësor, pushim lehonie etj).